

ENTI RREGULLATOR I UJIT
REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
2026

Nr.	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e kthimit të përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit	Tarifa
1	08.01.2026	1. Raportet e performancës së UKT për cilësinë e ujit të rrjetit të Tiranës për vitet 2020–2025. 2. Gjetjet e inspektimeve të kryera nga ERRU për Tiranën gjatë të njëjtës periudhë. 3. Informacion mbi masat administrative ose gjobat që janë marrë ndaj UKT për shkelje të parametrave të cilësisë së ujit. 4. Kopje të udhëzimeve, standardeve ose rregulloreve që UKT duhet të përmbushë për sigurimin e ujit të pijshëm. 5. Informacion mbi raportimin e detyrueshëm nga Bashkia dhe UKT mbi cilësinë e ujit dhe pasojat e shkeljes së standardeve.	20.01.2026	Pyetje nr. 1 - Raportet e performancës së UKT për cilësinë e ujit të rrjetit të Tiranës për vitet 2020–2025. <u>Përgjigje ERRU:</u> Në zbatim të gërmës (d), të nenit 5; gërmës (dh) dhe (h) të nenit 7 të ligjit nr. 10138, datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik”; pikës 2, të nenit 4 të VKM-së nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”” e ndryshuar, insitucioni përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik. Informacionet e kërkuara, të cilat lidhen vetëm me cilësinë e ujërave të pijshëm, mund të merren dhe administrohen vetëm nga institucioni përgjegjës.	Elektronikisht	Nuk ka

				Pyetje nr. 2 - Gjetjet e inspektimeve të kryera nga ERRU për Tiranën gjatë të njëjtës periudhë. <u>Përgjigje ERRU:</u> Nuk ka inspektime të realizuara gjatë kësaj periudhe. Ka vetëm një raport monitorimi, mbi monitorimin e ankesave I cili është për periudhën janar 2018 - qershor 2020, pra përfshin vetëm 6 mujorin e parë të vitit 2020. Raportin e gjeni bashkëlidhur. Pyetje nr. 3 - Informacion mbi masat administrative ose gjobat që janë marrë ndaj UKT për shkelje të parametrave të cilësisë së ujit. <u>Përgjigje ERRU:</u> Vlen përgjigjia e pyetjes nr. 1. Pyetje nr. 4 - Kopje të udhëzimeve, standardeve ose rregulloreve që UKT duhet të përmbushë për sigurimin e ujit të pijshëm. <u>Përgjigje ERRU:</u> Aktet rregullatore janë si më poshtë:		
--	--	--	--	---	--	--

				1. Kushtet e licencës së miratuar nga KKRR, që i bashkëlidhen vendimit për licencim shoqërive UK së bashku me formatin e licencës. 2. Kodi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve i cili është i miratuar me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve sh.a” i cili është detyrim për të gjitha shoqëritë UK dhe tek pjesa e dytë e tij Sistemet e furnizimit me ujë, pika 2.11, faqja 26, Cilësia e ujit. Bashkëlidhur gjeni dokumentat e sipërpërmendur. Pyetje nr. 5 - Informacion mbi raportimin e detyrueshëm nga Bashkia dhe UKT mbi cilësinë e ujit dhe pasojat e shkeljes së standardeve. <u>Përgjigje ERRU:</u> Vlen përgjigjia e pyetjes nr. 1.		
2	05.02.2026	Në lidhje me impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN): Sa impiante të trajtimit të ujërave të ndotura janë	10.02.2026	Njësia UK Kavajë është pjesë përbërëse e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës. Në njësinë Kavajë,	Elektronikisht	Nuk ka

		aktualisht në rrethin e Kavajës? Cilat janë dhe ku ndodhen impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura të rrethit të Kavajës?(vendodhja e impianteve).		në territorin e saj administrativ, operon vetëm 1 impiant i trajtimit të ujërave të ndotura, konkretisht në Qerret të Kavajës.		
3	11.02.2026	- Sa persona fizikë dhe juridikë janë pajisur me leje Kategoria D për përpunimin e ujërave të ndotura bazuar në Vendimin Nr. 958, datë 06.05.2009? - Kopje të listës së subjekteve të pajisur me leje Kategoria D për përpunimin e ujërave të ndotura, ku të përfshihet edhe afati i dhënies së lejes.	09.03.2026	Të pajisur me licencë për kategorinë D, përpunimin e ujërave të ndotura, janë 5 (pesë) shoqëritë rajonale ujësjellës kanalizime (SHRUK) e mëposhtme: - SHRUK Lezhë, - SHRUK Durrës (duke përfshirë ITUN në Durrës, Kavajë dhe Gjiri i Lalzit), - SHRUK Pogradec - SHRUK Shkodër (duke përfshirë ITUN Velipojë dhe Shirokë), - SHRUK Korçë.	Elektronikisht	Nuk ka
4	24.02.2026	1. Proceset e emërimit/përzgjedhjes · Lista e pozicioneve vakante ose të shpallura për konkurrim nga data 01.09.2025 e në vijim; 2. Transparenca e kandidatëve	03.03.2026	<i>1. Proceset e emërimit / përzgjedhjes</i> Enti Rregullator i Ujit nuk ka patur asnjë pozicion vakant apo të shpallur për konkurrim nga data 01.09.2025 e në vijim, pasi struktura organizative e institucionit ka qenë e plotësuar plotësisht gjatë kësaj periudhe. Për rrjedhojë, nuk janë zhvilluar procedura	Elektronikisht dhe me postë zyrtare	Nuk ka

		· Nëse ka raste, kërkojmë nëse CV-të e kandidatëve janë publike. Masa administrative në zbatim të Ligjit nr. 138/2015: Gjithashtu, kërkojmë informacion nëse, gjatë periudhës 01.09.2025 – në vijim, Institucioni juaj ka marrë masa administrative në zbatim të Ligjit nr. 138/2015, ndaj zyrtarëve të zgjedhur, të emëruar apo stafit drejtues. Për secilin rast (nëse ka), kërkojmë të informohemi mbi: • funksionin/pozicionin; • llojin e masës administrative; datën e vendimit.		rekrutimi apo konkurrimi për pozicione pune. 2. <i>Transparenca e kandidatëve</i> Duke qenë se gjatë periudhës së sipërcituar nuk janë zhvilluar procedura konkurrimi, nuk ka raste të publikimit të CV-ve të kandidatëve. 3. <i>Masa administrative në zbatim të Ligjit nr. 138/2015</i> Gjatë periudhës 01.09.2025 e në vijim, Enti Rregullator i Ujit nuk ka marrë masa administrative në zbatim të Ligjit nr. 138/2015 ndaj zyrtarëve të emëruar, stafit drejtues apo punonjësve të institucionit.		
5.	27.04.2026	1- Sa është sasia e ujit pa të ardhura në vitin 2025? 2- Sa orë furnizim me ujë ofrojnë secila nga ndërmarrjet e krijuar pas reformës së ujësjellësve? 3- Sa orë ujë garantohej në 61 bashkitë e vendit, për secilën specifikisht? 4- Sa orë ujë të pijshëm ka në ditë Tirana, listoni për vitet 2020-2025? 5- Cilat janë ndërmarrjet me çmimin më të lartë të ujit	11.05.2026	Përgjigje bashkëlidhur (Kthim përgjigje)	Elektronikisht	Nuk ka

		aktualisht? Listoni bashkitë bashkë me çmimet përkatëse?				
6.	06.07.206	Kërkesë për informacion për procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e Komisionertit të ERRU-së: 1. A ka përfunduar Komisioni i Përzgjedhjes procedurën e vlerësimit të kandidatëve? 2. Nëse po, në cilën datë është marrë vendimi përfundimtar i Komisionit? 3. A i është përcjellë Këshillit të Ministrave propozimi për emërimin e kandidatit? 4. Nëse po, në cilën datë është dërguar shkresa përcjellëse? 5. Ju lutem, më vini në dispozicion një kopje të shkresës së përcjelljes (duke mbuluar çdo të dhënë personale, nëse është e nevojshme), si dhe numrin e protokollit dhe datën e saj.	15.07.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije se me datë 29.04.2026, dokumentacioni i aplikimeve për pozicionin e anëtarit të Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) të administruara pranë ERRU-së i është dorëzuar Ekipit Përzgjedhës. Ekipi Përzgjedhës është organi i ngarkuar me procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së kandidateve për anëtare të KKRR. Sa i takon konkretisht pyetjeve Tuaja, ju informojmë se Enti Rregullator i Ujit nuk ka informacion për asnjë nga pikat e mëposhtme.	Elektronikisht	Nuk ka

7.	21.08.2026	1. Sa kontrole, inspektive, monitorime apo verifikime ka kryer ERRU pranë UKD sh.a. që nga krijimi i shoqërisë? 2. Për secilin rast, lutemi të specifikoni datën, objektin e kontrollit dhe përfundimet. 3. A ka konstatuar ERRU shkelje, problematika apo mangësi në funksionimin e UKD sh.a.? Nëse po, cilat? 4. A ka marrë ERRU masa, ka dhënë rekomandime apo ka lëshuar urdhra ndaj UKD sh.a.? Të vihen në dispozicion kopjet përkatëse. 5. A i ka zbatuar UKD sh.a. rekomandimet e dhëna nga ERRU? Nëse jo, cilat rekomandime kanë mbetur pa u zbatuar? 6. Sa ankesa të konsumatorëve ndaj UKD sh.a. janë administruar nga ERRU? 7. Cilat kanë qenë problematikat kryesore të evidentuara në këto ankesa? 8. A ka konstatuar ERRU probleme lidhur me cilësinë dhe vazhdimësinë e furnizimit me ujë në zonën e shërbimit të UKD sh.a.? 9. Çfarë të dhënash disponon ERRU për nivelin e humbjeve në rrjetin e	04.09.2026	1. ERRU në mënyrë periodike (vjetore) monitoron të gjitha shoqëritë UK në lidhje me treguesit e performancës. Në vijim të analizës hartohet dhe Raporti Vjetor i Performancës së shoqërive UK. Njëkohësisht, , çdo vit analizohet dhe hartohet Bilanci Ujit, i cili analizon çdo shoqëri por edhe të gjithë sektorin. Të gjitha këto raporte gjenden në ëbsite e ERRU, konkretisht https://erru.al/raportet/ . Sikurse në këto raportime nuk janë konstatuar problematika apo pranë ERRU nuk janë paraqitur ankesa, nuk janë realizuar inspektive. 2 dhe 3. Nuk ka inspektive dhe as verifikime. 4. Në lidhje me rekomandimet e lëna mund ti referoheni raporteve të performancës dhe të bilancit të ujithttps://erru.al/raportet/ . 5. SHRUK Dibër ende nuk ka tarifa si shoqëri rajonale por është në proces aplikimi që nga qershori 2026. Në momentin e pajisjes me tarifa si shoqëria rajonale, kësaj shoqërie do t'i vendosen	Elektronikisht	Nuk ka
----	------------	--	------------	---	----------------	--------

		UKD sh.a. dhe si ka ndryshuar ky tregues që nga krijimi i shoqërisë? 10. A ka konstatuar ERRU problematika në lidhje me arkëtimet, faturimin, debitorët ose mbulimin e kostove të shërbimit? 11. A i ka përmbushur UKD sh.a. detyrimet rregullatore dhe raportuese ndaj ERRU? 12. A ka pasur raste të mosrespektimit të detyrimeve rregullatore nga UKD sh.a.? Nëse po, cilat kanë qenë masat e marra? 13. A ka kryer ERRU ndonjë vlerësim të performancës së UKD sh.a.? Nëse po, kërkojmë raportin ose dokumentin përkatës. 14. Si renditet UKD sh.a. në raport me treguesit e performancës së shoqërive të tjera rajonale të ujësjellës-kanalizimeve?		<i>objektiva performance për t'u arritur. Në këtë moment fillon dhe ndjekja e zbatimit të tyre.</i> 6 dhe 7. Referuar pyetjes nr. 6 dhe nr. 7, Enti Rregullator i Ujit nuk ka pasur dhe nuk ka trajtuar ankesa të konsumatorëve drejtuar Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Dibër. 8. Në lidhje me pikën nr. 8, Enti Rregullator i Ujit nuk ka konstatuar apo të ketë pasur ankesa në lidhje me cilësinë dhe vazhdimësinë e furnizimit me ujë në zonën e shërbimit të kësaj shoqërie. 9. Mund t'i referoheni raporteve të Bilancit të Ujit, të publikuara në web: Viti 2023: https://erru.al/wp-content/uploads/2024/12/Raporti-Bilanci-i-Ujit-2023.pdf Viti 2024: https://erru.al/wp-content/uploads/2026/01/Raporti-Bilanci-i-Ujit-2024_final.pdf 10. Mund t'i referoheni raporteve të performancës, të publikuara në web: https://erru.al/raportet/	
--	--	--	--	---	--

				11. Po, i ka përmbushur. <i>SHRUK</i> Dibër është shoqëri e licencuar nga <i>ERRU</i>. Kjo shoqëri ende nuk ka tarifa si shoqëri rajonale por përgjatë kësaj periudhe (qershor 2026) ka aplikuar dhe është në proces dorëzimi dokumentacioni plotësues. <i>SHRUKD</i> raporton në mënyrë periodike lidhur me treguesit e performancës dhe bilancin e ujit. 12. Jo, nuk ka pasur. 13. Po. Raportet vjetore gjenden të publikuara në faqen zyrtare të <i>ERRU</i>, konkretisht si më poshtë: Viti 2023: https://erru.al/wp-content/uploads/2024/08/Raporti-i-Performances-ERRU-2023.pdf Viti 2024: https://erru.al/wp-content/uploads/2025/08/Raporti_Performances_2024-31.07.2025_compressed.pdf Viti 2025, do të publikohet së shpejti. Mund të përditësoheni pranë faqes https://erru.al/raportet/ 14. Raportet e performancës, të gjitha të publikuara në web japin informacion të dedikuar për renditjen e shoqërisë për secilin tregues. Viti 2023: https://erru.al/wp-content/uploads/2024/08/Raporti-i-Performances-ERRU-2023.pdf		
--	--	--	--	--	--	--

				content/uploads/2024/08/Raport-i-Performances-ERRU-2023.pdf Viti 2024: https://erru.al/wp-content/uploads/2025/08/Raport-Performances-2024-31.07.2025_compressed.pdf Viti 2025, do të publikohet së shpejti. Mund të përditësoheni pranë faqes https://erru.al/raportet/		
--	--	--	--	--	--	--

Ky regjistër është përditësuar në datën 08.09.2026.